



100 Vjet Pavarësi

## REPUBLIKA E SHQIPERISE

### Këshilli Kombëtar i Ujit

#### VENDIM

Nr. 3 , datë 12.10. 2012

#### PËR

#### “MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT TË LUMIT MAT”

Në mbështetje të nenit 6 pika “c” dhe nenit 10, i Ligjit Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, dhe me propozim të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Mat të shprehur me vendimin Nr. 10, datë 02.04.2012, për “Miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Mat”, Këshilli Kombëtar i Ujërave,

#### VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit të Lumit Mat, që i bashkelidhet këtij vendimi;
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës të lumit Mat dhe Agjenisa e Ujit e Basenit Mat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Fatmir MEDIU

Zv/Kryetar i KKV

dhe

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

KRYETARI

Sali BERISHA


**Flamur NOKA**

**Minister i Brendshem**



**Ridvan BODE**

**Minister i Financave**



**Edmond HAXHINASTO**

**Minister i Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes**

**Vangjel TAVO**

**Minister i Shendetsise**


**Genc RULI**

**Minister i Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit**



**Sokol OLLDASHI**

**Minister i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit**



## RELACION

### PËR

#### “MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT TË LUMIT MAT”

Nje nga fushat prioritare per Qeverine Shqiptare eshte fusha e menaxhimit te ujerave, nepermjet hartimit te programeve te veprimeve, qe do te synojne nje miremenaxhim, shfrytezim sa me racional te burimeve ujore, per te siguruar nje eficence sa me te larte te tyre per jeten dhe zhvillimin social-ekonomik te vendit.

Objektivat e Qeverise se Shqiperise ne kuader te integritimit European jane ne harmoni te plote me Qëllimin e Direktives Kuader te Ujit, qe është themelimi i kuadrit për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore te brendshëm, ujërave transitore, ujërave bregdetare dhe ujërave nëntokësore. (Neni 1).

Instrumenti planifikues i përgjithshëm qe do te përmbushë objektivat e DKU është përgatitja dhe implementimi i planit te menaxhimit te basenit ujqor për secilin basen ujqor rajonal brenda kufijve kombëtarë te çdo shteti anëtar te BE siç përshkruhet ne Nenin 13 te DKU.

Planet e Menaxhimit te Baseneve ujembledhese perbejne instrumentin kryesor per zbatimin dhe do t'u sherbejne vendimarrjesve lokale e qendrore dhe gjithë aktoreve te perdorimit te rezervave ujore ne vendimarrjet e tyre ne kete fushe, si dhe do të orientojne menaxhimin e burimeve ujore në një mënyrë të qëndrueshme dhe të balancuar ne zhvillimin ekonomik e social te zones, duke marrë në konsideratë interesat sociale, ekonomike, mjedisore.

Keto plane sigurojne nje forcim nderinstitucional, nepermjet bashkepunimit te te gjithë aktoreve te perfshire ne administrimin dhe shfrytezimin e burimeve ujore ne menyre te qendrueshme, duke përfshire masa adaptimi ndaj ndyshimeve klimatike, masa per permiresimin e efciences se ujit, te ekosistemeve, menaxhimin dhe mbrojtjen e ujerave nderkufitare, etj.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave ka marre disa iniciativa me partneret nderkombetare me qellim arritjen e nje menaxhimi te integruar te rezeravave ujore dhe harmonizimin e legjislacionit tone me legjislacionin perkates te BE.

Ne kete kuader, MMPAU me mbeshtetjen e projektit per Implementimin e Planit Kombetar per Perafrimin e Legjislacionit Mjedisor, INPAEL, kane perfunduar Raportin per Planin e Menaxhimit te Basenit te Lumit Mat.

Plani pilot i menaxhimit per Basenin e Matit, është përgatitur me një qellim te dyanshëm:

- Te përgatisë një plan menaxhimi te basenit lumor sa me shume qe te jete e mundur ne përputhje me kërkesat e përgjithshme te Direktivës Kuadër te Ujit (DKU).
- Te japë rekomandime dhe udhëzime për autoritetet zbatuese se si te vënë ne zbatim procedurat dhe te gjenerojë informacionin mungues për përgatitjen e planeve te ardhshëm për menaxhimin e baseneve ujore ne Shqipëri

Ne kete plan-menaxhim janë përmbledhur ne një te gjitha hapat e veçante kohore dhe janë strukturuar me qëllim fillimin e diskutimeve te procedurave planifikuese dhe rritjes se ndërgjegjësimit për informacionin e kërkuar për përgatitjen e planit te menaxhimit tërësor te basenit ujqor.

Elementet kryesore te ketij plani jane:

- Rregullim i kufijve te basenit te lumit Mat duke përfshirë rajonet e Lezhës dhe te Kurbinit;
- Rregullim i kufijve ne format elektronik ndërmjet rretheve, komunave dhe bashkive;
- Qartësim i përgjegjësiave ndërmjet Prefekturës, Rretheve, Bashkive dhe kompanive te ujit;
- Riorganizim i kompanive ujore ne njësi me te mëdha;
- Rishikim i strukturave tarifore për shërbimet e ujit.
- Përcaktim dhe karakterizim i te gjitha trupave ujore sipërfaqësore dhe depozitimet nëntokësore.
- Sigurim i parametrave te vlerave limit për statusin e gjendjes sasiorë, kimike dhe ekologjike te gjitha trupave ujore.
- Vazhdim i monitorimit vëzhgues siç përshkruhet ne këtë plan;
- Fillim i programeve monitoruese investigative për pikat e nxehta mjedisore siç përshkruhet ne këtë plan.

Nepermjet ketij plani do te realizohet nje vleresim real, sasior dhe cilesor i rezervave ujore ne kete rajon, nepermjet inventarizimit te plote te tyre, te perdoruesve te ujit, analizes dhe parashikimit te niveleve dhe prurjeve, klasifikimit te tyre ne kohe dhe hapesire, nxjerrjes se nje bilanci uhor ne perputhje me kerkesen per uje, vleresimit ekonomik, do te orientoje drejt nje mireadministrimi te integruar te burimeve ujore.

Rritja e kapaciteteve prodhuese hidroenergjitike, sigurimi i nje furnizimi te vazhdueshem me uje te pijshem dhe per vaditje, si ne sasi dhe cilesi, do te sigurojne nje impakt pozitiv ne jeten sociale dhe ne zhvillimin ekonomik te kesaj zone, me rritje te produktivitetit bujqesor dhe industrial, uljes se kosatos se prodhimit ne menyre te konsiderueshme, si dhe ne rritjen e investimeve te drejtperdrejta.

Zbatimi i ketij plani do te sjelle permiresimin dhe forcimin e mbledhjes se të dhënave hidrologjike, permiresimin dhe forcimin e kapaciteteve te parashikimit hidrologjik dhe mjeteve hidrologjike të modelimit, si edhe sistemet mbështetëse për marrjen e vendimeve.

Me respekt,

Fatmir MEDIU

Zy/Kryetar i KKK

dhe



Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujërave